

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Analiza e Foreign Policy Journal për Shqipërinë: Reforma në drejtësi ka krijuar një pushtet pa llogaridhënie
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/25/analiza-e-foreign-policy-journal-per-shqiperine-reforma-ne-drejtesi-ka-krijuar-nje-pushtet-pa-llogaridhenie685688456/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 08:35:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	25 shtator 2026, 08:29:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 25 shtator 2026, 08:28:00 UTC → 25 shtator 2026, 08:30:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3a8c0864e83d6330f74b6cfef85ac41f318d50df66f29df4d4488dccb9f5051a
TEKSTI	c3cb7182c0fa444316c6fb103702030e3ef935f6ebe6ad2e5e7c904bf3c820dd
PAMJA	74990641d4d07bd935164de5dbfbf39067ac2e30be5dfdb314a360f150b223ed

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	601d2e6c598fb6381a3f361cb71a1eb5adbe5d21bf9ef1c115b99ef8e7b1bdb9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	8b8efb9319bb60e287a9053a50eed732645594d6e8c6608cdf651dfbc0b1533
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/601d2e6c598fb6381a3f361cb71a1eb5adbe5d21bf9ef1c115b99ef8e7b1bdb9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET KRYESORE TË FUNDIT

Analiza e Foreign Policy Journal për Shqipërinë: Reforma në drejtësi ka krijuar një pushtet pa llogaridhënie

25/09/2026 10:29



Media Foreign Policy Journal ka publikuar një analizë të zgjeruar mbi reformën në drejtësi në Shqipëri, duke u ndalur te funksionimi i SPAK-ut, përdorimi i paraburgimit dhe rasti i kryebashkiakut të Tiranës, Erion Veliaj.

Në shkrimin e firmosur nga Timothy Mason trajtohen zhvillimet e dekadës së fundit në sistemin e drejtësisë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe pasojat që, sipas autorit, reforma ka sjellë në funksionimin e institucioneve.

Shkrimi ngre gjithashtu pikëpyetje mbi respektimin e procesit të rregullt ligjor dhe llogaridhënien e institucioneve antikorupsion në Shqipëri.

Shkrimi i plotë i Foreign Policy Journal, shkruar nga Timothy Mason:

Më 15 shtator, Gjykata e Lartë e Shqipërisë lejoi vijimin e mbajtjes në paraburgim të kryebashkiakut të Tiranës, Erion Veliaj. Kryebashkiak që nga viti 2015, Veliaj ka kaluar tashmë më shumë se 19 muaj në paraburgim pa një vendim dënimi. Këtë verë, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë i gjykoi të papërshtatshme nga pikëpamja kushtetuese arsyetimet e Gjykatës së Lartë për këtë paraburgim, kur shfuqizoi tërësisht vendimin e gjykatës më të ulët. Shkaku ishte se ajo nuk kishte marrë parasysh alternativa më pak shtrënguese, as faktin që Veliaj mbetet zyrtar i zgjedhur.

Në fund, Gjykata e Lartë iu përgjigj duke e vazhduar gjithsesi paraburgimin e tij. Ende nuk e ka dhënë arsyetimin. Ja ku ka përfunduar një dekadë "reformë në drejtësi" e mbështetur nga Perëndimi në Shqipëri: te një sistem prokurorial aq i fuqishëm sa u mbijeton dy qortimeve nga vetë gjyqtarët kushtetues të vendit.

Por, nuk filloi kështu. Në vitin 2016, Uashingtoni dhe Brukseli e shtynë Shqipërinë të krijonte SPAK-un, Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Ai u ngrit si një organ i pavarur dhe i mbrojtur nga ndikimet, me kompetenca për të ndjekur zyrtarët e korruptuar dhe rrjetet e krimit të organizuar që ishin ngulitur në institucionet shtetërore. Teoria, si gjithmonë me këtë lloj inxhinierie teknokratike, ishte se më shumë pushtet institucional, i ushtruar nga njerëzit e duhur, do të prodhonte më shumë shtet ligjor. Bëj venting për gjyqtarët. Spastro të korruptuarit. Ndërto një makineri prokuroriale aq të fortë sa më në fund t'u kërkojë llogari të fuqishmëve.

Reformatorëve duhet t'ua njohim të paktën këtë: procesi i vettingut nuk ishte pa dhembë. Sipas vetë Departamentit të Shtetit, më shumë se gjysma e gjyqtarëve dhe prokurorëve që kaluan nëpër të ose u shkarkuan për pasuri të pajustificuar apo lidhje me krimin e organizuar, ose dhanë dorëheqjen që të mos i nënshtroheshin procesit. Kjo është një arritje e vërtetë. Ia vlen ta themi hapur, në vend që të pretendojmë se i gjithë projekti ishte bosh që në fillim.

Por spastrimi i gjyqtarëve të këqij nuk është e njëjta gjë me ndërtimin e një sistemi që i

I Kryesore



Mesazhi i presidentit iranien për Trump, Pezeshkian: Ne jemi gati për marrëveshje, SHBA duhet të vendosë për fundin e luftës

07:43

Top Story/ "Kërkoj ekspertim të telefonit jashtë Shqipërisë", gazetarja Hoxha zbarch detajet nga seanca me dyer të mbyllura, çfarë deklaroi Vlorë Hyseni në SPAK

21:21

Fjalimi i Netanyahu në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, dhjetëra diplomatë lënë sallën: Nëse ka frikacakë të tjerë të largohen tani

22:59

Parashikimi i motit/ Dita e sotme sjell reshje, shtrëngata dhe dëborë në zonat malore

07:05

VIDEO/ Kosova e nis Nations League me këmbë të mbarë, për 'Dardanët' vendos Muriqi që ua dedikon golin ish krerëve të UÇK

22:43

I Më të lexuarat

Top Story/ "Kërkoj ekspertim të telefonit jashtë Shqipërisë", gazetarja Hoxha zbarch detajet nga seanca me dyer të mbyllura, çfarë deklaroi Vlorë Hyseni në SPAK

"Dumani përzuri Vlorën nga zyra", Murrizi bën deklaratën e fortë në Top Story: E nxori nga qershori i 2025

"Burg, burg", një grup protestuesish përplasen me Çuçin dhe bashkëshorten në kafene, si përgjigjet deputeti i PS dhe Delina Fico

Blokohen specat dhe açuget/ Jo vetëm perimet, Shqipëria ka probleme edhe me produktet e detit. Bllokohen në Itali

"Lashë në mes përkthimin e librit të ish-shefit të kundërzbulimit të STAS-it", rrëfimi i Auron Tares: Historia e spiunazhit në Tiranë ia kalon edhe Luftës së Ftohtë

"Goca dhe Gra" rikthehet në ekranin e Top Channel me ndryshime, kush janë moderatorët e sezonit të ri?

"Po si nuk i fiku njeri radarët për mua moj motër", Kryemadhi batuta dhe ironi për Vlorë Hysenin: Meta i ndizte se kishte hallin e vendit, puthte...

Top Story/ "Mbroitja do jetë arroqante".

bindet ligjit. Një dekadë më vonë, makineria që ndërtoi SPAK-u i ngjan gjithnjë e më shumë asaj që supozohej të zëvendësonte: e fuqishme, e errët dhe që nuk i jep llogari askujt. Ngarkesa e çështjeve të prapambetura në gjykata, që ajo supozohej të ndihmonte ta zbraste, përkundrazi ka shpërthyer: nga rreth 16.000 çështje në pritje në rreth 200.000 sipas vlerësimeve. Shqiptarët e zakonshëm tani mund të presin 15 vjet për një vendim. Mbi gjysma e të burgosurve në vend ndodhen në paraburgim, një nga nivelet më të larta në Evropë. Sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ky mjet duhet rezervuar për rrezik real arratisjeje ose rrezik për publikun. Nuk duhet përdorur si gjendje pritjeje e zakonshme.

Edhe më shqetësues është përdorimi i paraburgimit për të anashkaluar vullnetin e votuesve, siç argumentojnë kritikët se ka ndodhur në rastin e Veliajt. SPAK-u e arrestoi në shkurt 2025 me akuza për korrupsion dhe pastrim parash. Ai i ka mohuar gjatë gjithë kohës akuzat. Shtatorin e kaluar, Këshilli Bashkiak i Tiranës e përdori paraburgimin e tij si bazë për të tentuar ta shkarkonte fare nga detyra. Kjo ndodhi përpara çdo dënimi, duke lejuar në fakt që një veprim prokurorial të bënte atë që nuk e kishte bërë kutia e votimit. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë e rrëzoi shkarkimin nga Këshilli.

Në fillim të çështjes, SPAK-u i mohoi Veliajt aksesin në rreth 60.000 faqe provash. Veçmas, dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese kundërshtuan kushtet në të cilat ai mbahej gjatë seancave, duke thënë se mbajtja e tij në një kabinë xhami ishte poshtëruese. Një mendim paralel në Gjykatën Kushtetuese shkoi edhe më larg se shumica. Ai arriti në përfundimin se provat nuk e kishin vërtetuar as dyshimin e arsyeshmë që nevojitej për ta mbajtur atë në paraburgim që në fillim. Madje edhe një anëtar aktual i Parlamentit Evropian, që nuk është aspak skeptik nga natyra ndaj institucioneve të mbështetura nga Brukseli, ka pyetur publikisht nëse 19 muaj paraburgim janë ende "rreptësisht të nevojshëm".

Kjo ndodh kur një agjenci e ndërtuar që të mos u japë llogari politikanëve përfundon duke mos i dhënë llogari as ligjit. Dhe kostot nuk kufizohen te drama e sallave të gjyqit. Investitorët e huaj e kuptojnë këtë model për atë që është. Deklarata e Departamentit të Shtetit për Klimën e Investimeve 2025 i njeht Shqipërisë një përmirësim të vërtetë në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit, nga 37 në 42. Po ashtu, ajo shënon rritjen e stokut të investimeve amerikane nga 300 milionë në 382 milionë dollarë brenda një viti të vetëm. Megjithatë, ajo e përshkruan ende Shqipërinë si një vend ku është e vështirë të bësh biznes. Si arsye përmend korrupsionin në prokurime, një ekonomi informale të mbifryrë dhe zbatimin e dobët të kontratave. Asnjë fushatë marketingu nuk mund ta kompensojë për një ekonomi një sistem drejtësie që së pari arreston dhe më pas justifikon.

Asgjë nga këto nuk është argument për të treguar butësi ndaj korrupsionit; Shqipëria këtë reputacion nuk e ka fituar kot. Por një aparat antikorrupsion që nuk i jep llogari askujt, që lëviz me ritmin e vet dhe e trajton procesin e rregullt ligjor si opsional, nuk është shtet ligjor. Është thjesht një adresë tjetër për të njëjtin pushtet diskrecional të vjetër. Reforma e vërtetë supozohej ta zëvendësonte atë. Nëntëmbëdhjetë muaj pas fillimit të paraburgimit të Veliajt, është e drejtë të pyesim nëse e ka bërë.


Top Channel

I Aktualitet »



Aksident në aksin 'Rrogogzhinë-Lushnjë', plagosen dy persona

25/09 10:32



Kapriçot e motit/ Pas muajsh thatësire, Fierin e përfshijnë reshjet e dendura

25/09 10:07



Plagosja me armë në Lezhë/ Kamerat e sigurisë zbardhin konfliktin, autorët u larguan me makinë, shpallen në kërkim

25/09 09:59



Shiste kokainë me motorin e shpërndarjes së ushqimit, arrestohet 31-vjeçari në Lushnjë

25/09 09:35

"Burg, burg", një grup protestuesish përplasen me Çuçin dhe bashkëshorten në kafene, si përgjigjet deputeti i PS dhe Delina Fico

25/09 07:49

Parashikimi i motit/ Dita e sotme sjell reshje, shtrëngata dhe dëborë në zonat malore


25/09 07:05

I Kryesore »



Darka Trump-Xi mbledh elitat në Shtëpinë e Bardhë/ Të ftuarit e Titanëve të Teknologjisë, kurthi i Thukididit, Arabella 15-vjeçare dhe dollia simbolike

25/09 10:31



Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb

25/09 10:27



Takimi i Këshillit European të Korporatave/ Rama nga New York: Paqja nuk i paraprin zhvillimit ekonomik, është kusht për ta bërë atë të mundur

25/09 10:22



Kombëtarja humb edhe një mbrojtës gjatë grumbullimit, zbulohet gjendja e Asllanit. Maran bën manovrat e fundit para Bjellorusisë

25/09 10:01



Plagosja me armë në Lezhë/ Kamerat e sigurisë zbardhin konfliktin, autorët u larguan me makinë, shpallen në kërkim

25/09 09:59



Shpërthim i fuqishëm në Athinë, shembet një ndërtesë dykatëshe dhe plagoset një kalimtar. Dyshimet e para të policisë

25/09 09:35

Na ndiqni:



I Video »



Top News- Shpërndarës ushqimi dhe kokaine/ Lushnje, arrestohet motoristi i porosive



Top Channel/ Shiste kokainë me motorin e shpërndarjes së ushqimit, arrestohet 31-vjeçari në Lushnjë



Top Channel/ Pas muajsh të tërë thatësire, Fierin e përfshijnë reshjet e dendura të shiut



Top News – Vuçiç dorëhiqet pa dëbuar rusët. Presidenti serb: Do të flas me Putin për naftën



Top News – Vezë edhe në Nju Jork, Rama pritet me protestë nga një grup shqiptarësh



"Agjente serbe! Të neveris!", Plas mes Vlora Hysenit dhe Klod Lalës! Dalim video dhe përgjime të reja

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Për'puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet

Top Channel

Rreth Top Channel
Kontakt
Bileta – Portokalli
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.